



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Shprehi Komunikimi

Ngarkesa: 4 ects, 40 orë mësimore, 20 leksion/20 seminar
Viti / Semestri: Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze
Kodi i Etikës: Kodi i Etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: T'u ofrojë studentëve një hyrje teorike në fushën e shkencës së komunikimit si një disiplinë ndërdisiplinore dhe e aplikuar. T'i pajisë studentët me njohuri themelore mbi modelet, konceptet dhe qasjet teorike kryesore të komunikimit. Të zhvillojë ndërgjegjësimin për rëndësinë e komunikimit në shoqëri dhe rolin e tij në formësimin e kulturës dhe marrëdhënieve ndërpersonale.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësojë studentët për të kuptuar dhe përkufizuar elementët bazë të komunikimit, karakteristikat dhe parimet e tij.
2. Të analizojnë dhe të dallojnë katër kontekstet kryesore të komunikimit: ndërpersonal, në grup, publik dhe mediatik.
3. Të stimulojë pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime, ushtrime ndërpersonale dhe prezantime publike si pjesë e zhvillimit të kompetencës komunikuese.

Rezultatet e pritshme: Në fund të kursit studentët që arrijnë të plotësojnë kushtet

1. Të jenë të aftë të: vlerësojnë teoritë e komunikimit në mënyrë efektive, t'i zbatojnë ato në jetën e tyre të përditshme si dhe në një numër kontekstesh të ndryshme, veçanërisht në atë ndërpersonal dhe familiar.
2. Studentët do të jenë të aftë të përballen me studime dhe kërkime sistematike në fushën e komunikimit. Ata do të përmirësojnë aftësitë e tyre për të analizuar dhe sintetizuar materiale në këtë fushë.